



## AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHQIPTIT

### **SHPLLJE PËR KOORDINATOR PROJEKTI/SPECIALIST I BAZËS SË TË DHËNAVE PËR PROJEKTIN “MBËSHTETJA E DREJTËSISË TRANZITORE DHE TRAJTIMI I SË SHKUARËS NË SHQIPËRI” 2024-2026**

#### **Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit**

Në mbështetje të Ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” (i ndryshuar), neni 9/1, 10, 22/1; Ligjit nr. 83/2018 “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për personat e zhdukur (ICMP)”, si dhe Vendimit nr. 222, datë 09.05.2024 i Autoritetit për miratimin e protokollit mbi marrëveshjet praktike lidhur me koordinimin në zbatimin e projektit “Mbështetja e drejtësisë tranzicionale dhe trajtimi i të shkuarës në Shqipëri”.

shpall Procedurat për përzgjedhjen dhe kontraktimin e një *Koordinator projekti / Specialist i bazës së të dhënave për implementimin e Projektit “Mbështetja e drejtësisë tranzicionale dhe trajtimi i të shkuarës në Shqipëri”, 2024-2026, (më poshtë do të quhet Koordinatorin i Projektit).*

- **Kategoria e pagës: Paga bruto mujore 149 000 (njëqindedyzetënëntëmijë) lekë.**

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

**19/08/2024**

#### **1- Detyrat dhe përgjegjësitë:**

I mbështetur nga ekipi i Autoritetit, dhe ICMP, Koordinatorin i projektit:

1. Bashkërendon punën ndërmjet Autoritetit dhe ICMP për çdo aktivitet pjesë e planit të veprimtimit të projektit, miratuar në mbledhjen e Komitetit Drejtues;
2. Angazhohet në hetimet administrative për përcaktimin e lokacioneve ku më tej do të kërkohet me metoda dhe mjete të përparuara të kërkimit, duke bashkërenduar punën me organet vendore ( mbledhja e lejeve të nevojshme nga autoritetet vendore dhe policia e shtetit për vizitat dhe vlerësimet përkatëse në vend; sigurimi që autoritetet lokale dhe policia e shtetit të ofrojnë të gjithë mbështetjen e nevojshme logjistike, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, makineritë dhe personelin që konsiderohet i

- nevojshëm nga AAD i ICMP-së;
3. Harton raportet e hetimeve administrative dhe siguron që rezultatet e hetimeve të tilla të jenë në dispozicion të Departamentit të Arkeologjisë dhe Antropologjisë ("AAD") të ICMP-së për qëllime të shqyrtimit dhe vizitave dhe vlerësimeve eventuale të vendeve;
  4. Lobon me familjarë, grupe interesi dhe institucione që kanë rol në procesin e identifikimit të personave të zhdukur gjatë diktaturës, në çdo rast të lidhur me qëllimin dhe fokusin e projektit;
  5. Administron bazën e të dhënave duke rregjistruar, inventarizuar materialet arshivore përfshirë edhe raportimet e familjarëve të personave të zhdukur;
  6. Përditëson dhe mirëmban të dhënat në Sistemin e të dhënave identifikuese (IDMS);
  7. Koordinon për llogari të Autoritetit procesin e përgatitjes si në aspektin tematik ashtu edhe logjistik të mbledhjeve të Komitetit Drejtues apo edhe takimeve të tjera ad hoc të lidhura me agjendën e projektit;
  8. Përgatit raportime të brendshme për ecurinë e projektit apo për çështje specifike sa herë që i kërkohet nga Titullari i Autoritetit, organi kolegjal apo Sekretari i Përgjithshëm;
  9. Ofrim i përditësimeve mbi zbatimin e aktiviteteve të përshkruara sipas paragrafëve a) deri në f) të Protokollit lidhur me koordinimin në zbatimin e projektit "Mbështetja e drejtësisë tranzicionale dhe trajtimi i së shkuarës në Shqipëri" ("Protokolli"), në baza mujore për ICMP;
  10. Ofron përkrahje për aktivitetet e Autoritetit në fushën e personave të zhdukur gjatë periudhës së Komunizmit;
  11. Merr pjesë në përzgjedhjen e granteve fituese për shoqërinë civile;
  12. Koordinon marrëdhënien AIDSSH-ICMP sa i takon projektin për të zhdukurit dhe atë me institucionet e tjera mbi çështjen e të zhdukurve.

## **Rezultatet e pritshme**

1. Dëshmi të mbledhura gojore mbi të zhdukurit në të gjithë vendin.
2. Publikim i dëshmimeve, pasqyrim në faqen zyrtare të Autoritetit.
3. Rezultate konkrete të sintetizuara të punës hulumtuese në kuadër të hetimeve administrative për përzgjedhjen e lokacioneve ku do të kërkohet me metoda të përparuara.
4. Databazë me të gjithë elementët e mbledhur për të zhdukurit për të cilët është bërë aplikim.
5. Kontribut konkret i pasqyruar në faqen zyrtare të AIDSSH për çështjen e të zhdukurve.
6. Raporte periodike ku pasqyrohet secila prej kërkesave dhe realizimeve të mësipërme.

## **Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

- **Të zotërojnë** diplomë universitare të nivelit “Master” në Shkenca Shoqërore, Juridike apo te ngjashme.

*(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*

- Njohja e situatës aktuale të çështjes së marrë në shqyrtim, është vlerë e shtuar.

Përvojë pune: Të ketë mbi 5 vjet përvojë në fushën për të cilën është diplomuar si dhe të ketë eksperience qoftë edhe me kohë të pjesshme në projekte dy apo shumëpalëshe.

Përparësi do të ketë përvojë e mëparshme në administrimin e sistemeve të bazave të të dhënave, në fushën e drejtësisë tranzicionale dhe kërkimit të personave të zhdukur.

Kërkesa gjuhësore: Njohuri shumë të mira të gjuhës angleze, të folur e të shkruar dhe të prezantimit në shqip dhe anglisht.

Kërkesa të tjera specifike: Njohuri të mira në programet kompjuterike microsoft Office, Access

Niveli i certifikatës së sigurisë: Sekret. Të plotësojë kriteret për t’u pajisur me certifikatë të sigurimit të personelit, sipas VKM nr.188/2015.

## **Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:**

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojnë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kriterëve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- e) të mos jetë i/e dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

## **2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kërkesë, letër motivimi.

- Një kopje të jetëshkrimit në formatin europass.

- Fotokopje e diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit.
- Fotokopje e listës së notave, nëse ka listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në shtetin shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.
- Fotokopje e librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë).
- Fotokopje e letërnjoftimit (ID).
- Vërtetim i gjendjes shëndetësore.
- Vetëdeklarim i gjendjes gjyqësore.
- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.
- Emër, adresë dhe numër kontakti të punëdhënësit të fundit.

**Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 19/08/2024.**

**3.**

### **NJOHURITË MBI LEGJISLACIONIN TË CILAT DUHET TË KETË KANDIDATI:**

Njohuritë mbi legjislacionin të cilat duhet të ketë kandidati:

- a) Njohuri mbi Ligjin Nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të RPSSH”;
- b) Njohuri mbi Ligjin Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, i ndryshuar;
- c) Njohuri mbi Ligjin Nr. 9887, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
- d) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- e) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
- f) Njohuri mbi Ligjin Nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”;
- g) Njohuri mbi Udhërfyesin për të drejtat e familjarëve të personave të zhdukur gjatë periudhës së komunizmit (faqe ëeb e Autoritetit);
- h) Njohuri mbi librin, “Protokoll i Bournemouth-it për mbrojtjen dhe hetimin e varreve massive” (i botuar nga ICMP);
- i) Njohuri mbi Ligjin nr. 108/2014 “Për policinë e shtetit”
- j) Njohuri mbi Vendimin nr. 680, datë 2.9.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Institutit të Mjekësisë Ligjore”
- k) Njohuri mbi Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

#### **4. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

---

##### **Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me Dokumentacionin e dorëzuar:**

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

##### **Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

#### **5. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

---

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit do të shpallë fituesin në faqen zyrtare të Autoritetit, <http://autoritetidosjeve.gov.al/>. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.